

BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Në bazë të nenit 25 dhe 47 paragrafi 1 pika 20 nga Ligji për Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15 dhe 6/16), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë miratoi

VENDIM PËR LËSHIM NË QARKULLIM TË KARTËMONEDHAVE ME VLERË NOMINALE 10 DHE 50 DENARË

1. Me këtë vendim lëshohen në qarkullim kartëmonedhat me vlerë nominale 10 dhe 50 denarë me shenjë të shtypjes "MAPT 2018" (MARS 2018) dhe me karakteristikat e parapara në Vendimin për emetimin dhe karakteristikat themelore të kartëmonedhave me vlerë nominale 10 dhe 50 denarë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 218/16 dhe 12/17), duke filluar nga data 15 maj i vitit 2018.

2. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e shpalljes në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

Nr.V. 02-15/VI-4/2018
29 mars viti 2018
Shkup

Guvernator dhe Kryetar
i Këshillit të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë
Dimitar Bogov